

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**/Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues **Mizahir Shabani**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. F. nga fshati G. i K., komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm, PP.nr.1392/2016 të datës 30.11.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Enis Gashi dhe të akuzuarit, më datë **19.11.2018**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari:

**A. F.**, nga i ati A. dhe e ëma Sh., e lindur K., i lindur më ... në fshatin G. i K., komuna e Rahovecit, ku edhe tani jeton, me nr.pers. ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, i ati i tre (3) fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### S e p s e:

Nga data e pavërtetuar e gjerë me dt.21.01.2016, në shtëpinë e tij, në fsh. G. i K., Komuna e Rahovecit, me qëllim që vetës t'i sjell përfitim pasuror, në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën e nenit 39 të Ligjit për energjinë elektrike të Republikës së Kosovës, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që jashtë njëisorit elektrik me nr.12734033 përmes kabllor 4x16 është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS-divizioni Gjakovë i ka shkaktuar dëme në shumën prej 2,115.72 €.

**Këso dore ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.**

**Andaj, Gjykata me aplikimin e neneve 4, 41, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74, nenit 320 të KPRK-së, të akuzuarit ia shqipton:**

## D Ë N I M I N M E K U S H T

Dënimin me gjobë në shumën prej dy qind (200) euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nëntë dhjetë (90) ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej një (1) viti, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara KEDS – Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30,00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP.nr.1392/2016 të datës 30.11.2016,, kundër të pandehurit A. F. nga fshati G. i K., komuna e Rahovecit, komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datën 19.11.2018, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Enis Gashi, i akuzuari, ndërsa nuk ka qenë prezent përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës edhe pse gjykata ka prova se është ftuar në mënyrë të rregullt por mungesën e tij nuk e ka arsyetuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit i cili ka qëndruar në tërësi pranë saj, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se ndihet fajtor dhe ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mos pranimit të fajësisë dhe pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet e pranimit të fajësisë. Po ashtu është kërkuar edhe mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili ka deklaruar se është i pajtimit me pranimin e fajësisë.

Andaj nga të lartcekurat, pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 248 par.4 të KPPK-së, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës fillestare është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata nuk ka proceduar administrimin e provave.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë: shikimi në procesverbalin mbi konstatimin e gjendjes faktike nr. 1237928, i dt.21.01.2016, fatura nr. DGJ16HPO5658, e

dt. 25.01.2016, si dhe foto dokumentacion si dhe shkresa tjera në lëndë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit.

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marr parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 dhe 74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marr sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me kusht me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës që kërkesën pasurore – juridike ta realizojnë në procedurën e rregullt civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC**  
**Deparatamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr. 488/2016 me datë 19.11.2018**

**B. Profesional**  
**Armond Qmega**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Mizahir Shabani**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.